

54

PYETJE-PËRGJIGJE

Breth Namazit të Dy Bajrameve



ME DIJETARIN E NDERUAR

Muhammed Ibën Salih el-'Uthejmin

Selef.org 
Kurani dhe Sunneti
sipas kuptimit të Selefëve të këtij Umumi



Pyetja nr.1: A ka ezan dhe ikamet namazi i Bajramit?

Përgjigje: Namazi i Bajramit nuk ka as ezan e as ikamet, siç është vërtetuar kjo nga Suneti.¹ Mirëpo, disa prej dijetarëve – Allahu pastë mëshirë për ta – kanë thënë se duhet të thërritet “*es-Salatul-Xhaami’ah*”, porse kjo fjalë nuk ka argument, prandaj është e dobët dhe nuk mund të bëhet analogji (*kijas*) me eklipsin, ngase eklipsi u vjen njerëzve papandehur, ndryshe nga Bajrami. Kështu që, Suneti është që të mos thirret ezan dhe as ikamet në namazin e Bajramit dhe as të thërritet “*es-Salatul-Xhaami’ah*”. Porse njerëzit dalin për të falur namazin, e kur të vijë imami ata falen pa ezan e pa ikamet. E më mbas mbahet hytbeja.



¹ E ka transmetuar Bukhari në: Kapitulli: Namazi i dy Bajrameve; tema: Ecja në këmbë apo mbi ndonjë kafshë për të falur Bajramin dhe namazi është para hytbes dhe s’ka ezan dhe as ikamet (959, 960).

Pyetja nr.2: A është sunet që imami të mbajë hytbe mbi minber në namazin e Bajramit?

Përgjigje: Po, disa dijetarë mendojnë se ajo është sunet, ngase në hadithin e Xhabirit (*radij-Allahu 'anhu*) ka ardhur se i Dërguari - *'alejhis-salatu ues-selam* - u mbajti hytbe njerëzve. Dhe tha (Xhabiri): “Pastaj ai zbriti dhe shkoi tek gratë dhe u tha...” - dhe zbritja bëhet nga një vend i lartë dhe prej atij vendi kryhet veprimi i zbritjes. Kurse disa dijetarë kanë qenë të mendimit se mos-mbajtja e hytbes mbi minber është më mirë. Dhe kjo çështje është e gjerë *in-shae-Allah*.



Pyetja nr.3: Cila është urtësia e marrjes së një rruge tjetër në ditën e Bajramit?

Përgjigje: Urtësia sipas nesh, së pari është që të pasojmë Pejgamberin - *sal-l'Allahu 'alejhi ue sel-lem* - se me të vërtetë kjo është prej Sunetit. Së dyti, prej urtësive është shfaqja e ritualit, rituali i namazit të Bajramit, në të gjitha pazaret e vendit. Së katërti, prej urtësive është gjithashtu vizitimi i njerëzve të pazareve, fukarenjve etj. Së pesti, kanë thënë gjithashtu se prej urtësive është se të dyja rrugët do të dëshmojnë për të ditën e Kijametit.



Pyetje nr.4: A falet namazi i Bajramit pasi që njeriu nuk arriti ta kapë atë?

Përgjigje: Mendimi i saktë është se ai nuk falet (nëse të humbet) dhe se kujt i humbet namazi i Bajramit bie nga ai detyra e faljes së tij, ndryshe nga namazi i Xhumasë, sepse njeriut po i humbi namazi i Xhumasë fal namazin e Drekës. Dhe dallimi midis atyre të dyjave

është se namazi i Drekës është obligim për kohën (e drekës – *Dhuhri*), dhe nëse njeriu nuk mundi të falë namazin e Xhumasë obligohet që të falë Drekën, ndryshe nga Bajrami, sepse Bajrami ka namazin e tubimit, nëse njeriu e arrin tubimin falet e nëse jo, bie obligimi (i faljes së namazit të Bajramit).



Pyetja nr.5: Cili është suneti në namazin e Bajramit, a duhet të falet në Xhami apo shkretëtirë (d.m.th. në vend të hapur)? Nëse përgjigja është se Suneti është që të falet në shkretëtirë, atëherë qyteti sa vjen e zgjerohet, dhe sa herë që është caktuar një shesh për namazin e bajramit (musale), ai më pas është rrethuar nga ndërtesat nga të gjitha drejtimet, kështu që nuk i shkon atij sheshi që të quhet shkretëtirë. Na jepni dobi, Allahu ju shpërbleftë.

Përgjigje: Suneti i namazit të Bajramit është që ai të falet në shkretëtirë, siç ka vepruar Pejgamberi - *sal-ḷAllahu 'alejhi ue sel-lem* -. Nëse qyteti zgjerohet, atëherë duhet që vend-falja e namazit të bajramit duhet të zhvendoset në shkretëtirë. E nëse nuk është e mundur që të zhvendoset, atëherë s'ka gjë, ngase vendosja e saj në shkretëtira nuk është obligim (*uaxhib*) por e pëlqyeshme (*mustehab*).



Pyetja nr.6: Ç'grykim kanë tekbiret shtesë në namazin e Bajramit? Dhe çfarë grykimi ka ngritja e duarve gjatë atyre tekbireve?

Përgjigje: Tekbiret shtesë janë sunet. Nëse njeriu i bën ato merr shpërblim, e nëse nuk i bën nuk ka gjë. Por, ai nuk duhet t'i lërë ato, në mënyrë që të dallohet namazi i Bajramit nga namazet e tjera. Ndërsa sa i përket asaj që thuhet midis atyre tekbireve, dijetarët kanë thënë se falenderohet Allahu dhe çohen salavate mbi Pejgamberin - *sal-ḷAllahu 'alejhi ue sel-lem* -. Dhe nëse nuk e bën këtë, atëherë s'ka gjë. Kurse ngritja e durave për çdo tekbir është sunet.



Pyetja nr.7: Ç'grykim ka nëse Bajrami bie në një ditë me Xhumanë?

Përgjigje: Nëse dita e Xhumasë përkon me ditën e Bajramit, atëherë patjetër që duhet të falet namazi i Bajramit dhe namazi i Xhumasë, ashtu siç bënte Pejgamberi - *sal-Allahu 'alejhi ue sel-lem* -. Pastaj, ai që erdhi në namazin e Bajramit nuk është i detyruar që të vijë në namazin e Xhumasë. Mirëpo ai duhet medoemos të falë namazin e Drekës, ngase namazi i Drekës është obligim i atij vakti e s'mund të lihet.



Pyetja nr.8: Ç'grykim ka nëse arrij imamin kur ai është duke u falur namazin e Bajramit dhe po bën tekbiret shtesë, a t'i bëj ato tekbire që humba në fillim, apo si të veproj? Na jepni dobi Allahu ju shpërbleftë.

Përgjigje: Nëse lidhesh pas imanit gjatë kohës që ai po bën tekbiret, atëherë së pari bëj tekbirin fillestar, pastaj paso imamin në ato që të kanë mbetur, kurse ato që humbe në fillim nuk i bën.



Pyetja nr.9: Ç'grykim ka urimi në ditën e Bajramit?

Përgjigje: Urimi për Bajram është i lejuar, mirëpo nuk ka ndonjë urim specifik, madje urimet që janë bërë traditë tek njerëzit janë të lejuara, për sa kohë që nuk përmbajnë gjynah.



Pyetja nr.10: A ka Bajrami një hytbe apo dy hytbe? Na jepni dobi, Allahu ju shpërbleftë.

Përgjigje: Suneti është që Bajrami të ketë vetëm një hytbe, por nëse bëhen dy hytbe s'ka gjë, ngase edhe kjo është transmetuar nga Pejgamberi - *sal-Allahu 'alejhi ue sel-lem* -. Mirëpo, nuk duhet lënë pas dore këshillimi i grave që është i veçantë për to, siç bënte Pejgamberi - *'alejhis-salatu ues-selam* -. Nëse ai fliste me diçka që e zmadhonte zërin dhe gratë e dëgjonin, atëherë ai e linte fundin e hytbes me këshilla vetëm për gratë. Dhe nëse nuk fliste me diçka që e zmadhonte zërin dhe gratë nuk dëgjonin dot, atëherë ai shkonte tek ato i shoqëruar nga një ose dy burra dhe u fliste aq sa kishte mundësi.



Pyetja nr.11: Ç'gjykim ka nëse njerëzit nuk e marrin vesh që është Bajram, por e marrin vesh pasi që ka dalë dielli.

Përgjigje: Nëse nuk e marrin vesh që është Bajram, përveç se pasi që ka dalë dielli, atëherë ata e hanë ditën e Fitër Bajramit dhe dalin për të falur namazin të nesërmen, kurse për Kurban Bajramin ata do të dalin për të falur namazin ditën e nesërme dhe nuk therin kurban përveç se pasi që të kenë falur namazin e Bajramit, ngase kurbanin vjen pas namazit. Ajo që është e njohur nga medh`hebi është se ata e therin kurbanin nëse u humbet namazi me daljen e diellit, kurse mendimi i parë është më i sigurtë.



Pyetja nr.12: Cili është mendimi juaj për atë që kanë thënë dijetarët e fik'hut - Allahu i mëshiroftë - se është sunet ngrënia e mëlçisë së kurbanit? A ka argument për këtë?

Përgjigje: Kanë thënë se është sunet të hash nga kurbanit dhe për këtë ka argument nga Kur'ani dhe Suneti. Ka thënë Allahu i Lartësuar:

فَكُلُوا مِنْهَا وَأَطِعُوا الْبَائِسَ الْفَقِيرَ ﴿٢٨﴾

“Hani nga ato (kurbanet) dhe ushqeni nevojtarin e varfër!”²

Dhe Pejgamberi - *'alejhis-salatu ues-selam* - ka urdhëruar që të haet nga kurbanit dhe ai ka ngrënë nga kurbanit. Pra janë bashkuar dy sunete, suneti me fjalë dhe suneti me vepër. Kurse sa i përket zgjedhjes që të haet nga mëlçia, këtë e kanë zgjedhur dietarët e fik'hut ngaqë ajo është më e lehtë dhe më e shpejtë për t'u bërë e jo në aspektin se kjo është prej ibadetit.



Pyetja nr.13: Ç'gjykim ka falja e një numri namazesh të Bajramit në një vend³, na jepni fetva Allahu ju shpërbleftë.

Përgjigje: Nëse këtë gjë e kërkon nevoja atëherë s'ka problem. Ashtu siç e kërkon nevoja për namazin e Xhumasë, ngase Allahu i Lartësuar thotë:

وَمَا جَعَلَ عَلَيْكُمْ فِي الدِّينِ مِنْ حَرَجٍ

“Dhe Ai nuk ju ka vënë në Fe asnjë barrë.” [el-Haxh, 78]

² El-Haxh, 28.

³ **Shënim i përkthyesit:** D.m.th. të mos falet vetëm një namaz për Bajramin ku të mblidhen të gjithë njerëzit e vendit, por të falen një numër namazesh në sheshe apo xhami të ndryshme të vendit apo qytetit.

Dhe nëse nuk do ta pranojmë faljen e një numri namazesh, atëherë kjo do të shkaktojë dy privime për një pjesë njerëzish, privim nga namazi i Xhumasë dhe privim nga namazi i Bajramit.

Dhe shembull për nevojën e faljes së namazit të Bajramit është zgjerimi i qytetit, kështu që shkuarja e njerëzve nga njëra anë e qytetit për në anën tjetër të tij bëhet e vështirë. Por ama nëse nuk është nevoja që të falet një numër namazesh, atëherë ai falet vetëm në një vend.



Pyetja nr.14: Cili është mendimi juaj rreth asaj që thonë disa dijetarë të fik`hut se ai që bën itikaf del për të falur namazin e bajramit me rrobat që mbante veshur në itikaf?

Përgjigje: Mendimi ynë është se kjo bie ndesh me Sunetin, porse Suneti për Bajram është që njeriu të zbukurohet qoftë kur bën itikaf e qoftë kur nuk bën itikaf.



Pyetja nr.15: Çfarë gjykimi ka nëse harroen tekbiret e Bajramit derisa fillohet me këndimin, a të përsëritet namazi apo si të veprohet?

Përgjigje: Nëse harroet tekbiri në namazin e Bajramit derisa fillon këndimi atëherë ai nuk përsëritet ngase është një sunet të cilit i kaloi vendi, njësoj sikur të humbasë duaja me të cilën hapet namazi derisa të fillohet këndimi (i Kur'anit), atëherë ajo bie.



Pyetja nr.16: Çfarë gjykimi ka nëse arrihet imami gjatë tekbireve shtesë?

Përgjigje: Kaloj përgjigja për këtë, nëse e arrin atë gjatë tekbireve. Por nëse e arrin në ruku, atëherë ai bën vetëm tekbirin fillestar dhe pastaj bie në ruku, dhe nëse e arrin pasi që është çuar nga rukuja, ai nuk bie në ruku pasi ajo i humbi.



Pyetja nr.17: A konsiderohet xhami vendi ku falet Bajrami (musala) në mënyrë që të jetë sunet falja e dy rekateve aty ashtu siç falen në xhami?

Përgjigje: Po, musala e Bajramit është xhami dhe për këtë arsye i Dërguari - *sal-Allahu 'alejhi ue sel-lem* - i ndaloi gratë me menstruacione që të rrinë në të dhe i urdhëroi ato që të mos vijnë në xhami. Dhe në bazë të kësaj, nëse njeriu hyn në musale nuk duhet të ulet derisa të falë dy rekate, porse nuk duhet të falë nafile më shumë se ato dy rekate as para namazit dhe as pas tij, ngase Pejgamberi - *sal-Allahu 'alejhi ue sel-lem* - nuk falej as para dhe as pas namazit (në musale), kurse dy rekatet për xhaminë kanë shkak.



Pyetja nr.18: A ka ndonjë sunet të veçantë që bëhet natën e Bajramit?

Përgjigje: Nuk di ndonjë sunet të veçantë që të bëhet natën e Bajramit, me përjashtim të bërjes së dhikrit dhe tekbireve, siç ka ardhur në thënien e Allahut të Lartësuar:

وَلْتُكْمِلُوا الْعِدَّةَ وَلْتُكَبِّرُوا اللَّهَ عَلَىٰ مَا هَدَيْتُكُمْ وَلَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ ﴿١٨٥﴾

“...që të plotësoni numrin e ditëve të agjërimit dhe që ta madhëroni Allahun (në fund të agjërimit), për shkak se ju ka udhëzuar në rrugë të drejtë e që ta falënderoni Atë.”⁴

Ka ardhur një hadith që flet për mirësinë e gdhirjes zgjuar të dy netëve të bajramit, mirëpo për atë hadith kanë folur dijetarët (për pasaktësinë e tij) prandaj unë s'guxoj të them që kjo është sunet duke u bazuar në të tilla hadithe si ky.



Pyetja nr.19: Si është forma e tekbirit *mutlak* dhe si është forma e tekbirit *mukajjed*? Na jepni dobi, Allahu ju shpërbleftë.

Përgjigje: Forma e tekbirit është: “Allahu Ekber, Allahu Ekber, La ilahe illAllah, uAllahu Ekber, Allahu Ekber ue lillahil-hamd.” Ose e përsërit tekbirin tre herë: “Allahu Ekber, Allahu Ekber, Allahu Ekber.” Tekbiri *mutlak* është ai tekbir që është ligjëruar të thuhet në çdo kohë. Kurse tekbiri *mukajjed* është ai që thuhet mbas namazeve të obliguara. Dhe kanë përmendur ulematë – Allahu i mëshiroftë – se tekbiri *mukajjed* ka të bëjë vetëm me Bajramin e Kurbanit, që nga namazi i Sabahut në ditën e Arafatit, e deri në mbasditen e ditës së fundit të Teshrikut. Kurse tekbiri *mutlak* është ligjëruar në ditën e Bajramit të Fitrit dhe në Dhjetë Ditët e Dhul-Hixhes. Dhe e sakta është që tekbiri *mutlak* vazhdon nga Bajrami i Kurbanit deri në ditën e fundit të Teshrikut, dhe koha e tij është trembëdhjetë ditë. Dhe suneti është që të ngrihet zëri kur bën tekbiret, me përjashtim të grave, ngase ato nuk e ngrenë zërin.



Pyetja nr.20: Cili është suneti që bën njeriu për Bajram, para namazit?

⁴ El-Bekareh, 185.

Përgjigje: Suneti në Fitër Bajramin është që të haen hurma me numër tek, përpara se të dalësh për të shkuar në musale. Kurse në ditën e Kurban Bajramit suneti është që të haet nga kurbanit që theret pas namazit. Kurse marrjen e gusulit për namazin e Bajramit e kanë pëlqyer disa prej njerëzve të dijes, kanë pëlqyer gjithashtu veshjen e rrobave më të bukura. Por nëqoftëse merret vetëm abdes dhe vishen rrobat e zakonshme s'ka problem.



Pyetja nr.21: A është suneti i shkuarjes në musale ditën e Bajramit duke ecur apo i hipur mbi kafshë apo mjet udhëtimi?

Përgjigje: Është sunet që të shkohet në këmbë, por nëse është e nevojshme që të shkohet me ndonjë kafshë apo mjet udhëtimi s'ka problem.



Pyetja nr.22: Cilat janë ato sure që është sunet t'i këndojë imami në namazin e Bajramit pas Fatihës?

Përgjigje: Është e pëlqyeshme që të këndohet ose surej “Kaf” ose “Ikterabeti”⁵ ose sureja “Sebbihi”⁶ ose “el-Gashijeh”, ky është suneti. Edhe nëqoftëse këndohen sure të tjera s'ka problem.



Pyetja nr.23: Ç'gjykim ka bërja e hytbes së Bajramit përpara namazit, dhe ç'gjykim ka prezantimi në hytben e Bajramit? A është ajo kusht (shart) për pranimin e namazit?

⁵ Shënim i përkthyesit: d.m.th. sureja “el-Kamer”.

⁶ Shënim i përkthyesit: d.m.th. sureja “el-'Ala”.

Përgjigje: Bërja e hytbes së dy Bajrameve përpara namazit është bidat të cilin e kanë hedhur poshtë Sahabët - *radij-Allahu 'anhum* -. Kurse pjesëmarrja në hytben e dy Bajrameve nuk është obligim (*uaxhib*). Kush do le të prezantojë, të dëgjojë dhe të përfitojë. Dhe kush do le të ikë. Ajo nuk është kusht për saktësinë e namazit të Bajramit, ngase kushti vjen përpara të kushtëzuarit, kurse hytbeja mbas namazit të Bajramit.



Pyetja nr.24: A fillohet hytbeja e Bajramit me istigfar apo me tekbir apo me çfarë? Na jepni fetva, Allahu ju shpërbleftë.

Përgjigje: Sa i përket istigfarit, hytbeja nuk hapet me të, dhe unë nuk di që ta ketë thënë ndokush këtë. Kurse sa i përket tekbitit, Ulematë kanë mospajtim për këtë. Prej tyre ka që kanë thënë se fillohet me tekbir, dhe prej tyre ka që kanë thënë se fillohet me tahmid (duke lavdëruar Allahun). Dhe kjo çështje është e gjerë. Ai nëse thotë, “*Allahu Ekber, Allahu Ekber, La ilahe il-Allah, uAllahu Ekber, Allahu Ekber ue lil-lahil-hamd*”, e ka filluar me tahmid. Pra kjo është si një fjali e vetme. Dhe nëse thotë, “*El-hamdulillah, uAllahu Ekber, ue la ilahe il-Allah*”, poashtu e ka filluar hytben me tahmid. Dhe kjo çështje është e gjerë.



Pyetja nr.25: A është suneti që hatibi ta mbajë hytben e Bajramit në këmbë apo ulur?

Përgjigje: Suneti për hytben e Xhumasë dhe të Bajramit është që hatibi të rrijë në këmbë, ashtu siç është vërtetuar nga Pejgamberi (*sal-lAllahu 'alejhi ue sellem*).



Pyetja nr.26: Nëse një person do të therë kurban në vend të një tjetri, a bën që të rruhet ai i cili do ta there kurbanin për të?

Përgjigje: Dispozitat e kurbanit lidhen me personin për të cilin do të theret kurbanin, në kuptimin që njeriu nëse ngarkon dikë që të therë kurbanin e tij, atëherë dispozitat e kurbanit lidhen me atë që ka ngarkuar dikë tjetër që ta therë kurbanin e jo me personin e ngarkuar.



Petja nr.27: A i lejohet njeriut që të krehë flokët e tij gjatë dhjetë ditëve të Dhul-Hixhes, dhe kush është më e mirë për kurban, therja dashit apo therja e lopës?

Përgjigje: I lejohet njeriut që të heqë qimet/flokët e tij pasiqë ka therur kurbanin e tij, qoftë edhe në ditën e Bajramit, kurse dashi është më i mirë sesa një e shtata e lopës apo një e shtata e deve. Dhe nëse bën kurban me deve apo me lopë, atëherë fukahatë (dijetarët e Fik`hut) kanë thënë se kjo është më e mirë sesa me një dele.



Pyetja nr.28: Cilat janë ditët që quhen “*el-Ejam el-Ma'lumat*” dhe “*el-Ejam el-Ma'dudat*”, të cilat janë përmendur në Kur'an?

Përgjigje: “*el-Ejam el-Ma'lumat*” janë dhjetë ditët e muajit Dhul-Hixheh, kurse “*el-Ejam el-Ma'dudat*” janë ditët e Teshrikut.



Pyetja nr.29: Ç'grykim ka namazi i atij që bën vetëm tekbinin fillestar (*tekbir el-ihram*) në namazin e bajramit?

Përgjigje: Namazi i tij është i saktë nëse bën vetëm tekbirin fillestar sepse tekbiret shtesë mbi tekbirin fillestar dhe tekbiret e tjera që bëhen për çdo lëvizja në namaz janë sunet.



Pyetja nr.30: Ç'grykim ka mbajtja e armës gjatë namazit të bajramit?

Përgjigje: Nëse është e nevojshme që të mbahet le ta mbajë, në të kundërt jo.



Pyetja nr.31: Ç'grykim ka të folurit gjatë hytbes së Bajramit?

Përgjigje: Kanë thënë disa dijetarë se ndalohet të folurit kur imami mban hytben në ditën e bajramit, kurse disa të tjerë kanë thënë se s'ka problem, ngaqë prezantimi në hytben e bajramit nuk është obligim, kështu që edhe dëgjimi i saj nuk është obligim. Dhe s'ka dyshim se prej edukatës është që të mos flitet sepse kur flet largon vëmendjen tënde dhe largon vëmendjen e atij të cili i flet apo e dëgjon dhe e shikon.



Pyetja nr.32: Ç'grykim ka therja e kurbanit në musalen (vend-faljen) e bajramit?

Përgjigje: Therja e kurbanit në musalen e bajramit është prej Sunetit, ngase këtë e ka bërë Pejgamberi - *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* -. Mirëpo sot njerëzit e kanë bërë zakon që ta therin kurbanin nëpër shtëpitë e tyre në mënyrë që të mos bëjnë pis vendin përreth musaleve të bajramit.



Pyetja nr.33: Sa zgjat ndalesa e mos-heqjes së flokëve, qimeve dhe thonjve në dhjetë ditët e Dhul-Hixhes?

Përgjigje: Zgjat deri sa të therësh kurbanin. Nëse e ther kurbanin merr fund ndalimi.



Pyetja nr.34: Në vendin tonë truprojat vijnë në musale ditën e bajramit përpara ardhjes së emirit dhe kur vjen emiri ata i bien daulleve si përsëritje për të duke e shoqëruar me vegla muzikore. Ç'gjykim ka kjo gjë dhe a lejohet të falësh namazin e bajramit tek ajo musale kur gjendja është e tillë? Na jepni dobi, Allahu u shpërbleftë.

Përgjigje: Daullja nuk lejohet, kurse defi mund të lejohet në këtë rast, por jo në kohën e ibadetit dhe në vendin e ibadetit.



Pyetja nr.35: Ç'gjykim ka namazi i Bajramit dhe si falet ai? Cilat janë kushtet e tij dhe koha e tij?

Përgjigje: Namazi i Bajramit është farz ajn për burrat, sipas fjalës më të saktë mes fjalëve që kanë thënë njerëzit e dijes, ngase Pejgamberi - *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* - ka urdhëruar për faljen e namazit të Bajramit dhe përkujdesej për të, aq sa i urdhëroi të prezantonin edhe gratë e pamartuara, vajzat e reja dhe ato me menstruacione, porse i urdhëroi gratë me menstruacione që të qëndronin larg vendit të faljes. Dhe nëse njeriu i humb namazi i Bajramit, ai nuk e kryen atë, ashtu sikurse namazi i Xhumasë po humbi nuk kryhet. Porse Xhumaja ngaqë është në kohën e drekës,

kur humbet, njeriut i kërkohet që të falë namazin e drekës. Kurse në kohën e namazit të Bajramit s'ka namaz tjetër që të falet në atë kohë përveç Bajramit, kështu që, nëse humbet ai nuk kryhet dhe nuk ka namaz tjetër që të falet në vend të tij. Kurse forma e ligjshme e faljes së tij është e njohur: bën tekbirin fillestar (*tekbiiratul-ihram*) dhe duanë e hapjes, pastaj bën shtatë tekbire. Pastaj lexon “*Fatihane*” dhe një sure me të, ose suren “*Sebbihi*”⁷, ose suren “*Kaaf*” në rekatin e parë. Kurse kur çohesh për në rekatin e dytë bën tekbir dhe pastaj bën pesë tekbire të tjera pasi që je çuar në këmbë. Pastaj lexohen “*Fatihane*” dhe një sure. Nëse lexoi në rekatin e parë suren “*Sebbihi*”, në rekatin e dytë lexon suren “*el-Gashijeh*”. Dhe nëse lexoi në rekatin e parë suren “*Kaaf*”, në të dytin lexon “*Ikterabetis-Saatu uen-shekkal-Kamer*”.



Pyetja nr.36: A është prerja e kurbanit ditën e Bajramit obligim (uaxhib) apo sunet?

Përgjigje: Pyetja duhet të ishte: a është prerja e kurbanit uaxhib apo jo? Dijetarët kanë rënë në mospajtim për sa i përket obligueshmërisë së prerjes së kurbanit. Disa prej tyre thanë se kurbanit është obligim, sikurse është medh`hebi i Ebu Hanifes dhe siç ka ardhur në një dy mendimet që janë transmetuar nga Imam Ahmedi, si dhe një nga dy mendimet që janë në medh`hebin Malikij. Dhe ky është mendimi që ka zgjedhur Shejkhul-Islam Ibn Tejmijeh, ngase Pejgamberi - *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* - urdhëroi për prerjen e kurbanit dhe tregonte kujdes të veçantë për të.

Kurse të tjerë prej dijetarëve thonë se kurbanit është sunet i fortë, është e urryer që të lihet nga ai i cili ka mundësi të presë kurban.

⁷ Shënim i përkthyesit: D.m.th. sureja “*el-E'ala*”.



Pyetja nr.37: A është i ligjëruar namazi i Bajramit për udhëtarin?

Përgjigje: Nuk është ligjëruar namazi i Bajramit për udhëtarin ashtu siç nuk është ligjëruar për të namazi i Xhumasë po ashtu. Mirëpo, nëse udhëtari ndodhet në vendin ku falet namazi i Bajramit, atëherë ai është i urdhëruar që ta falë namazin me Muslimanët.



Pyetja nr.38: Ç'gjykim ka ai i cili e ka bërë zakon agjërimin e ditës së Hënë dhe të Enjte dhe rastisi që njëra prej atyre ditëve të bjerë në një prej ditëve të Teshrikut, a i agjëron ai ato ditë apo jo?

Përgjigje: Nëse dita e Hënë ose e Enjte bie në ditët e Teshrikut, atëherë ai nuk i agjëron ato, për shkak të hadithit të A'ishes dhe Ibn 'Umerit - *radij-Allahu 'anhum -*, të cilët kanë thënë: “Nuk lejohet në ditët e Teshrikut që të agjërohet, përveç nëse nuk gjen kurban, d.m.th. kur bën haxhin “*temetuë*” ose “*karin*”. Dhe dihet që nuk lejohet të bësh një harram me qëllim që të bësh një sunet.



Pyetja nr.39: Cili është mendimi juaj i nderuar Shejkh rreth festave që bëhen sot, siç është festa e ditëlindjes, festa e atdheut etj; dhe nëse ditët quhen për shembull “Dita e Atdheut”... a ndryshon gjykimi?

Përgjigje: Për sa i përket festës së ditëlindjes, nëse është për qëllim ditëlindja e 'Ijsa Ibën Merjem - *'alejhîs-salatu ues-selam -*, të cilin Kristianët e adhurojnë, atëherë s'ka dyshim se është harram për Muslimanët që ta marrin atë si festë. Dhe kjo është prej harrameve

më të mëdha, ngase ky është madhërim i simboleve të kufrit. Nëse njeriu e feston atë është në rrezik. Ama, nëse për qëllim është festimi i ditëlindjes së çdo njeriu, ndalimi i kësaj është më i afërt sesa urrejtja. E njëjta gjë edhe me festat e tjera që përkojnë me raste jo-Sheriatike. Kurse rastet Sheriatike janë: Fitri i Ramadanit, Bajrami i Kurbanit dhe Festa Javore që është Xhumaja.



Pyetja nr.40: Nëse e shikoj i vetëm hënën bajramit të Fitrit porse në vend nuk lajmërohet për shikimin saj, a ta ndërpres agjërimin dhe të festoj bajramin kurse i gjithë vendi do të agjërojë, duke qenë se unë po pasoj hadithin:

"صوموا لرؤيته وأفطروا لرؤيته."

"Agjëroni me shikimin e hënës dhe ndërpriteni agjërimin me shikimin e hënës." Apo duhet të pasoj njerëzit e vendit tim?

Përgjigje: Njerëzit e dijes thonë se njeriu nëse e shikon i vetëm hënën e muajit Sheual, ai e ka obligim që të agjërojë ngase hyrja e hënës së Sheualit në Sheriat vërtetohet veçse me dy dëshmitarë. Kurse disa dijetarë të tjerë janë të mendimit se ai e ndërpret agjërimin fshehurazi. Porse mendimi i parë është i famshëm në medh`hebin e Imam Ahmedit - *rahimehullah* -.



Pyetja nr.41: Nëse në qytet ka njerëz të dobët e të paaftë, si duhet ta falin namazin e Bajramit ata? Dhe kur lejohet therja e kurbanit, mbas namazit të tyre apo mbas përfundimit të namazit të imamit përgjegjës?

Përgjigje: Njerëzit e dijes thonë se nëse ka në qytet njerëz të paaftë që s'mund të dalin në musalen (vendfaljen) e Bajramit, atëherë falet

namazi i Bajramit në qytet për shkak të justifikimit, dhe në këtë rast therja e kurbanit lidhet me namazin që falet më përpara; nëse namazi i Bajramit falet së pari në musale, lejohet kurban; dhe nëse namazi i Bajramit falet së pari në qytet për të paaftët, lejohet kurban. Dhe nëse dikush thotë se kjo lidhet me namazin që fal vet personi: kush falet me njerëzit e qytetit në musale, gjykimi i kurbanit lidhet me namazin e tij në musale; dhe kush falet me ata që janë të paaftë, gjykimi lidhet me namazin që fal ai me ta.

Unë them: Nëse ka ndonjë që e thotë këtë, për fjalën e tij ka mendim.



Pyetja nr.42: Ç'gjykim ka dalja e grave për në musale, sidomos tani në kohën tonë kur janë shtuar fitnet dhe se disa gra dalin të zbukuruara e të parfumosura; e nëse themi se lejohet, atëherë çfarë thoni ju për fjalën e A'ishes - *radij-Allahu 'anha* -: “Sikur ta shikonte Pejgamberi - *sal-Allahu 'alejhi ue sel-lem* - çfarë kanë sajuar gratë, me siguri që do t'i kishte.”?

Përgjigje: Ne mendojmë se gratë duhet të urdhërohen që të dalin për në musalen e Bajramit dhe të dëshmojnë mirësinë dhe të marrin pjesë bashkë me Muslimanët në namazin dhe lutjet e tyre. Mirëpo, ato e kanë detyrë që të dalin veçmas, të pazbuluara e të paparfumosura. Kështu, ato bashkojnë zbatimin e Sunetit me mënjanimin e fitnes. Kurse ajo që ndodh nga disa gra që dalin të pambuluara dhe të parfumosura, kjo është si pasojë e injorancës së tyre dhe mangësisë së kujdestarëve të tyre. Ama kjo nuk e ndalon dispozitën e përgjithshme Sheriatike, që është urdhërimi i grave që të dalin për namazin e Bajramit. Kurse sa i përket fjalës së A'ishes - *radij-Allahu 'anha* - dihet se gjëja e lejuar nëse të shpie në harram është harram. Dhe nëse shumica e grave dalin me një paraqitje jo-

Sheriatike, ne padyshim që ne nuk i ndalojmë të gjitha! Por ama ne ndalojmë veçse ato gra të cilat dalin me të tillë paraqitje.



Pyetja nr.43: Nëse kam agjëruar njëzetë e nëntë ditë dhe në fund të ditës jepet lajmërimi që nesër është dita e tridhjetë, domethënë që unë duhet ta agjëroj atë, mirëpo unë udhëtova për në një vend tjetër dhe kur mbërrita atje më thanë se të nesërmen do të jetë dita e Bajramit në vendin e tyre, në të cilin shkova. Atëherë, a duhet të ndjek vendin tim dhe të agjëroj, apo duhet ta ndërpres dhe të festoj Bajramin me ata?

Përgjigje: Detyra jote është që ta ndërpresësh agjërimin me vendin në të cilin të kapi Bajrami. Pastaj, nëse muaji jot është i mangët nga njëzetë e nëntë ditëshi, atëherë plotësoje. E nëse u plotësuan njëzetë e nëntë ditë, atëherë muaji është me njëzetë e nëntë është edhe me tridhjetë, kështu që ti s'e ke detyrë që të plotësosh tridhjetë, përveç nëse muaji është i plotë me tridhjetë ditë në të dyja vendet. Në këtë rast e ke detyrë që të plotësosh tridhjetë ditë.



Pyetja nr.44: Nëse kam agjëruar njëzetë e nëntë ditë dhe pastaj festova Bajramin ditën e tridhjetë në vendin ku agjërova, mirëpo unë shkova mëngjesin e Bajramit në një vend tjetër, ndërkohë që unë e kam ndërprerë agjërimin, porse i gjeta njerëzit e atij vendi duke agjëruar. Atëherë, a të agjëroj apo të mos agjëroj dhe të festoj Bajramin tim?

Përgjigje: Ti s'e ke detyrë që të agjërosh sepse ti e ndërpreve agjërimin në mënyrë Sheriatike, kështu që u bë e lejuar për ty kjo ditë që të mos agjërosh, nëse perëndoi dielli në vendin tënd, pastaj ti udhëtove në një vend tjetër dhe arrite diellin përpara se të perëndonte, kështu që ti s'e ke detyrë që ta agjërosh atë ditë.



Pyetja nr.45: A është namazi në musale më i mirë, edhe nëse je në Mekke ose në Kuds, apo namazi në Haram (Vendi i Shenjtë) është më i mirë?

Përgjigje: Namazi i Bajramit në musale është më i mirë, mirëpo në Mekke është bërë zakon që nga kohët e vjetra që të falen në Xhaminë e Haramit (d.m.th. në Qabe). Po kështu, edhe në Medine janë falur në Xhaminë e Pejgamberit qysh prej një kohe shumë të gjatë, porse s'ka dyshim që namazi i atyre që janë në Medine është më i mirë në musale, siç ka qenë gjatë kohës së Pejgamberit - *sal-lallahu 'alejhi ue sel-lem* - dhe Prijësave të Drejtë.



Pyetja nr.46: Kur thuhet duaaja hapëse në namazin e Bajramit? A thuhet pas tekbirit fillestar apo pas tekbireve?

Përgjigje: Duaaja hapëse thuhet pas tekbirit fillestar, kështu kanë thënë dijetarët. Mirëpo kjo çështje është e gjerë, edhe nëse e lë duanë deri në tekbirin e fundit⁸ s'ka problem.



Pyetja nr.47: A është kusht që tekbiri mukajjed të bëhet mbas namazit që falet me xhemat apo është sunet që bëhet edhe nëqoftëse falesh vetëm?

Përgjigje: Ai është ligjëruar për t'u bërë qoftë kur njeriu është falur me xhemat dhe qoftë kur është falur vetëm, kjo është me e afërt (me të saktën). Kurse disa dijetarë mendojnë se ai është i ligjëruar vetëm atëherë kur njeriu falet me xhemat.

⁸ Shënim i përkthyesit: D.m.th. në tekbirin e fundit nga tekbiret dalluese të namazit të Bajramit



Pyetja nr.48: Ç'gjykim ka nëse e prish abdesin mbas namazit, a lejohet për të që të bëjë tekbire, e po ashtu, nëse del nga xhamia apo kalon kohë e gjatë (mbasi që ka përfunduar namazi)?

Përgjigje: Duhet të dihet se për tekbirin *mukajjed* nuk ka ndonjë tekst të saktë e të qartë nga i Dërguari - *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* -, mirëpo ka transmetime dhe ixhtihadate nga njerëzit e dijes, dhe kjo çështje është e gjerë. Madje edhe nëse e lë fare dhe mjaftohet vetëm me dhikrin e namazit, lejohet, sepse të gjitha janë dhikër për Allahun *'Azze ue Xhel-le*. Dhe nga ajo që dihet është se nëse ai e prish abdesin, atëherë bërja e dhikrit të namazit nuk shfuqizohet, ngase nuk është kusht për bërjen e dhikrit që të pastrohesh (d.m.th. të marrësh avdes etj. sh.p.). E njëjta gjë është edhe me tekbirin dhe e njëjta gjë është edhe nëse del nga xhamia, ngase bërja e dhikrit nuk shfuqizohet, e po ashtu edhe bërja e tekbireve. Ama nëse kalon kohë e gjatë (mbasi që ka mbaruar namazi), nëse është lënë nga neglizhenca, bërja e dhikrit shfuqizohet; e nëse është lënë nga harresa bëhet.



Pyetja nr.49: A duhet të bëhen tekbiret përpara dhikrit që bëhet kur mbaron çdo namaz?

Përgjigje: Nuk ka ardhur asnjë transmetim i saktë e i qartë nga Pejgamberi - *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* - për temën e tekbirit *mukajjed*, porse ato që kanë ardhur janë transmetime dhe ixhtihadate nga dijetarët. Dhe ata thonë se tekbiri është përpara dhikrit të përgjithshëm që bëhet me mbarimin e namazeve.



Pyetja nr.50: Tek ne, në disa xhamia muezini bën tekbire me mikrofon, kurse njerëzit përsërisin mbas tij atë që thotë ai. A konsiderohet kjo gjë prej bidateve apo është e lejuar?

Përgjigje: Kjo është prej bidateve, sepse është e ditur nga udhëzimi i Pejgamberit - *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* - për bërjen e dhikrit, se çdokush nga njerëzit i bën dhikër Allahut *Subhanehu ue Te'ala* me veten e tij. Prandaj nuk duhet që të dalësh nga udhëzimi i Pejgamberit - *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* - dhe i Sahabëve të tij.



Pyetja nr.51: Ç'gjykim ka kurbanit? Dhe a lejohet bërja e kurbanit me nijetin që shpërblimi i tij t'i shkojë një të vdekuri?

Përgjigje: Kurbanit është sunet i fortë për atë që ka mundësi. Kështu, njeriu bën kurban për veten e tij dhe për njerëzit e shtëpisë së tij. Ama që ta bësh kurbanin me nijetin që shpërblimi i tij t'i shkojë një të vdekuri, kjo nuk është prej Sunetit sepse nuk është transmetuar nga Pejgamberi - *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* - aq sa di unë, që ai të ketë bërë kurban më vete që t'i shkojë shpërblimi ndonjë të vdekuri, dhe as nuk di që ta ketë bërë këtë gjë ndonjë prej Sahabëve të tij gjatë jetës së tij - *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* -. Mirëpo njeriu e bën kurbanin për hesapin e tij dhe të familjes së tij. Dhe nëse ai e bën nijet që të jetë edhe i vdekuri me ta, s'ka problem.



Pyetja nr.52: Nëse vjen koha e therjes së kurbanit dhe në shtëpi nuk gjendet asnjë burrë, a i lejohet gruas që ta therë kurbanin?

Përgjigje: Po, gruas i lejohet që ta therë kurbanin ashtu siç i lejohet edhe të tjerëve, sepse parimi bazë është se burrat dhe gratë marrin pjesë njësoj si burrat në ibadete etj., përveç nëse vjen argumenti (për ndalimin e saj), pasi ka ardhur në transmetim të saktë, në ndodhinë e robërshës e cila ruante delet në këmbim të

një shpërblimi, dhe ujku plagosi një nga delet. Atëherë ajo mori një gur dhe e theri delen. Kjo ka ndodhur në kohën e Pejgamberit - *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* - dhe pastaj Pejgamberi - *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* - urdhëroi që të haej.



Pyetja nr.53: Ç'grykim ka ai që rruhet ditën e Bajramit të Kurbanit përpara se të shkojë në namazin (e Bajramit), duke patur parasysh që ai u këshillua që të mos e bënte këtë, porse ai këmbënguli që të rruhej përpara namazit?

Përgjigje: Grykimi për të është se ai nuk iu bind të Dërguarit - *sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem* -, ngase Pejgamberi ka thënë:

إذا دخل العشر و أراد أحدكم أن يضحى فلا يأخذ من شعره و لا بشرته
ولا من ظفره شيئاً

“Nëse hyn dhjetë-ditëshi dhe ndonjëri prej jush do që të therë kurban, atëherë të mos heqë asgjë nga qimet, as nga lëkura e as nga thonjtë e tij.”

Prandaj, ai e ka detyrë që të pendohet tek Allahu i Lartësuar për atë që bëri. Kurse për sa i përket kurbanit, kjo që bëri nuk e cënon aspak atë, ndryshe nga ç'mendojnë disa prej njerëzve të thjeshtë se nëse njeriu heq nga qimet apo thonjtë e tij, atëherë kjo gjë e bën të pavlerë kurbanin që pret ai. Pra, kjo (që besojnë ata njerëz) nuk është e vërtetë.



Pyetja nr.54: A i lejohet atij që bën kurban që t'i japë qafirit (mosbesimtarit) nga mishi i kurbanit të tij? Dhe a i lejohet atij që bën kurban që të hajë nga kurbanit i tij?

Përgjigje: I lejohet njeriut që t'i japë qafirit sadaka nga mish i kurbanit të tij, por me kusht që të mos jetë ky qafir prej atyre që i vrasin Muslimanët. E nëse është prej atyre që i vrasin Muslimanët, atëherë nuk i jepet gjë atij, për shkak të Fjalës së të Lartësuarit:

لَا يَنْهَكُمُ اللَّهُ عَنِ الَّذِينَ لَمْ يُقْتِلُواكُمْ فِي الدِّينِ وَلَمْ تُخْرِجُواكُمْ مِنْ دِيَارِكُمْ أَنْ تَبَرُّوهُمْ
وَتُقْسِطُوا إِلَيْهِمْ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُقْسِطِينَ ﴿٨﴾ إِنَّمَا يَنْهَكُمُ اللَّهُ عَنِ الَّذِينَ قَتَلُواكُمْ فِي
الدِّينِ وَأَخْرَجُواكُمْ مِنْ دِيَارِكُمْ وَظَهَرُوا عَلَىٰ إِخْرَاجِكُمْ أَنْ تَوَلَّوهُمْ

“Allahu nuk ju ndalon të silleni mirë dhe të jeni të drejtë ndaj atyre që nuk luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe që nuk ju dëbojnë prej shtëpive tuaja. Me të vërtetë, Allahu i do të drejtët. Allahu ju ndalon t'i bëni miq ata që luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe ju dëbojnë nga vatrata tuaja, si dhe mbështesin të tjerët që t'ju dëbojnë.”⁹

Kurse që njeriu të hajë nga kurban i tij, po (lejohet). Nëse njeriu e fali bajramin, theri kurbanin e tij dhe hëngri nga ai përpara se të hajë gjëra të tjera, atëherë s'ka problem, madje dijetarët thonë se kjo është gjëja më e mirë.



Përktheu: Alban Malaj
`Auli, Mekkeh
28 Ramadan 1434 Hixhrij / 6 Gusht 2013 Miladij

⁹ El-Mumtehineh, 8-9.